ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

TRAJNIMI I TRETË I EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

# MBROJTJA DHE SIGURIA NË PUNË NË FUSHËN E NDËRTIMIT

**15 Nëntor 2025**



www.oirk.org




## OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

- Sistemi i sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP)
- Faktorët e riskut
  - Puna me pajisje
  - Puna në lartësi
  - Puna në gërmime
  - Rrëshqitjet & Pengimet
  - Siguria nga zjarri
  - Siguria elektrike
  - Shenjat e sigurisë
  - Pajisjet personale mbrojtëse
  - Kontrollet sistematike mjekësore
  - Ndihma e parë
  - Ekranet shfaqëse
  - Trajtimi manual i ngarkesave
- Vlerësimi i riskut
- Hetimi i incidenteve/ aksidenteve dhe analiza e shkaqeve
- Detyrimet organizative
- Inspektimet në vendet e punës

# BURIMET E INFORMACIONIT NË PËRPUTHJE ME AKTET LIGJORE



## Burime kombëtare

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
- Sistemi informativ ligjor i Kosovës
- Ministria e Drejtësisë
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës
- Profesionistët juridikë dhe kompanitë ligjore
- Institucionet dhe agjencitë qeveritare

# SISTEMI I SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP)

Duke klikuar mbi linqet me poshtë, do të keni mundësi të informohi për aspektet e SSHP-së, si dhe shkarkoni të gjithë dokumentacionin në fuqi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
  - Manuale
  - Listat kontrolluese dhe shembuj të vlerësimit të riskut
  - Infografikat
- Inspektorati Qendror i Punës
  - Legjislacioni nga SSHP (Rregulloret për SSHP)
  - Listat kontrolluese



# LISTA E LEGJISLACIONIT NË RKS PËR SSHP

| Nr. | Emri i dokumentit |
|---|---|
| 1 | Ligj Nr. 08/L-261 i punës |
| 2 | Ligji Nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri |
| **3** | **Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë** |
| **4** | **Rregullore (MPMS) Nr. 01/2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë** |
| **5** | **Rregullore (MPMS) Nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës** |
| **6** | **Rregullore (MPMS) Nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr. 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës** |
| **7** | **Rregullore (MPMS) Nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës** |
| 8 | Rregullore (MPMS) Nr. 01/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës |
| 9 | Rregullore (MPMS) Nr. 02/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës |
| 10 | Rregullore (MPMS) Nr. 03/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë |
| 11 | Rregullore (MPMS) Nr. 05/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë |
| **12** | **Rregullore (MPMS) Nr. 06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vend ndërtimet të përkohshme apo mobile** |
| 13 | Rregullore (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë |
| 14 | Rregullore (MPMS) Nr. 08/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me fushat elektromagnetike në vendin e punës |
| 15 | Rregullore (MPMS) Nr. 09/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës |
| 16 | Rregullore (MPMS) Nr. 10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë |
| **17** | **Rregullore (MPMS) Nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës** |
| 18 | Rregullore (MPMS) Nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa |
| 19 | Rregullore (MPMS) Nr. 04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë |
| 20 | Rregullore (MPMS) Nr. 05/2016 për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punësuarve në risk nga ambientet shpërthyese |
| 21 | Rregullore (MPMS) Nr. 06/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës |

# BAZA LIGJORE E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP)

- ➢ Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
- ➢ Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri
- ➢ Ligji Nr. 03/L-212 i Punës
- ➢ Aktet normative nga Ligji
- ➢ Rregulloret e brendshme
- ➢ Sistemi i menaxhimit të SSHP-së



Në përputhje me:

- ✓ Standardin ISO 45001 për Menaxhim e SSHP
- ✓ Standardin IS0 14001 për Menaxhimin e Mjedisit
- ✓ Standardin ISO 9001 për Menaxhim të Cilësisë
- ✓ Direktivat Evropiane

# ISO 45001:2015 SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

**Përfitimet nga vendosja e standardit ISO 45001:2018**

- Humane (më pak lëndime në vendin e punës, sëmundje profesionale dhe raste të fataliteteve)
- Biznesore:
  - Produktiviteti dhe profitabiliteti
  - Punëtorë dhe konsumatorë të kënaqur
  - Reputacion, qëndrueshmëri dhe rezultate pozitive






# ISO 45001:2015 SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË




**Puna e kujt është cilësia?**

Cilësia e shërbimit të ofruar në institucion/ kompani është përgjegjësi e **secilit punonjës**.

# ÇKA KËRKON LIGJI NË NJË SHOQËRI / INSTITUCION?

## SISTEMIN E MENAXHIMIT TË SIGURISË SSHP-së



# ÇFARË ËSHTË SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË?

Siguria dhe shëndeti në punë është pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës. Aspektet e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë një tërësi e masave:



- Organizative
- Teknike
- Teknologjike
- Juridike
- Mjekësore
- Psikologjike
- Pedagogjike

Të gjitha këto me qëllim që të eliminohen apo të zvogëlohen në masën më të madhe të mundshme, shfaqja e risqeve në vendet e punës, ashtu që punëtorët të mbrohen nga lëndimet dhe sëmundjet profesionale, si dhe sëmundjeve që janë të lidhura me punën.

Siguria në punë paraqet: sistemin e rregullave, parimeve, procedurave, aplikimi i të cilave përmirëson sigurinë dhe shëndetin në punë.

# A KEMI DETYRIME LIDHUR ME SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË?

- Punëdhënësit edhe punëtorët kanë përgjegjësi në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Detyrimet kryesore të punëdhënësve janë parandalimi i risqeve duke zbatuar masa parandaluese.

- Shembuj të detyrimeve të punëdhënësit:
  - Krijon mënyra të sigurta dhe të shëndetshme të punës
  - Siguron pajisje të sigurta
  - Siguron pajisje personale mbrojtëse të përshtatshme
  - Ofron informata, udhëzime dhe trajnime për punëtorët



# A KEMI DETYRIME LIDHUR ME SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË?

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, gjithashtu kërkon që punëtorët të përmbushin përgjegjësitë e tyre si dhe të ndihmojnë punëdhënësit për mbrojtjen e punëtorëve.



Shembuj të detyrimeve të punëtorëve:

- Kujdeset për sigurinë dhe shëndetin në punë, për vete dhe të tjerët
- Bashkëpunon me punëdhënësin për sigurinë dhe shëndetin në punë
- Ndjekë trajnimet dhe udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi për të bërë punën në mënyrë të sigurt, si dhe për përdorimin e pajisjeve, mjeteve, substancave etj.
- Informon punëdhënësin, mbikëqyrësin ose përfaqësuesin e punëtorëve nëse mendon se vetë puna - ose masat jo adekuate të sigurisë - rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e ndonjërit

# SI MUND TË PËRMIRËSOJMË KUSHTET E PUNËS?

Ju mund të përmirësoni kushtet e punës përmes pjesëmarrjes aktive në siguri dhe shëndet në punë - është proces dy-drejtimësh, ku punëdhënësit dhe punëtorët/ përfaqësuesit e punëtorëve:

- Flasin me njëri-tjetrin
- Dëgjojnë shqetësimet e njëri-tjetrit
- Kërkojnë dhe ndajnë pikëpamjet dhe informacionin
- Diskutojnë çështjet në kohën e duhur
- Marrin vendime së bashku
- Besojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin



Pjesëmarrja e plotë shkon përtej konsultimit - punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre duhet të jenë të përfshirë në vendimmarrje.

# FAKTORËT E RISKUT (IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE NË VENDIN E PUNËS)




ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

# GRUPIMI I RREZIQEVE

| Rreziqet traumatike | |
|---|---|
| 1 | Sipërfaqe të pabarabarta ose të rrëshqitshme (të cilat mund të shkaktojnë rrëshqitje, pengesa, rënie etj.) |
| 2 | Automjete lëvizëse (pirunë, kamionë, etj.) |
| 3 | Pjesë lëvizëse mekanike të makinerive (p.sh. sistemet e konvejerëve) |
| 4 | Objekte dhe pjesë me sipërfaqe të rrezikshme (të mprehtë, të ashpër, etj.) |
| 5 | Sipërfaqe, materiale të nxehta ose të ftohta, etj. (p.sh. furra dhe boilerë) |
| 6 | Puna në lartësi |
| 7 | Puna në shkallë |
| 8 | Objekte që bien |
| 9 | Vegla dore (me dhe pa rrymë) |
| 10 | Siguria elektrike (instalimet dhe pajisjet elektrike, tokëzimi dhe rrufepritësi) |
| 11 | Siguria nga zjarri |
| 12 | Shpërthimi |
| 13 | Puna në hapësira të mbyllura |
| 14 | Puna në gërmime |
| 15 | Stabiliteti i sipërfaqes |
| 16 | Hapjet në sipërfaqe dhe mure |
| 17 | Pastërtia, rregulli në vendin e punës |

| Rreziqet fizike | |
|---|---|
| 18 | Zhurma |
| 19 | Dridhje |
| 20 | Ndriçimi |
| 21 | Mikroklima e brendshme |
| 22 | Klima e nxehtë ose e ftohtë (puna jashtë) |
| 23 | Rrezatimi UV, IR, lazer dhe mikrovalë, rrezatimi jo-jonizues |
| 24 | Rrezatimi jonizues |
| 25 | Shtypje e lartë |
| **Rreziqet nga kimikatet dhe pluhuri** | |
| 26 | Substanca kimike dhe materiale të rrezikshme |
| 27 | Pluhuri |
| 28 | Korrozioni (ndryshku) |
| 29 | Asbest |
| 30 | Kancerogjenë, mutagjenë |
| **Rreziqet psiko-sociale** | |
| 31 | Ngarkesa, mbingarkesa, shterimi fizik dhe mendor |
| 32 | Organizim i pamjaftueshëm i punës dhe komunikim i pamjaftueshëm me menaxhmentin dhe kolegët |
| 33 | Dhuna, ngacmimi (mobbing/bulling) |
| 34 | Puna i vetëm |
| 35 | Puna me palë (klientë, konsumatorë etj.) |
| 36 | Orari i punës, puna jashtë orarit, mungesa e kohës, menaxhimi i kohës |
| 37 | Puna në ndërrime, përfshirë ndërrimet e natës |
| 38 | Rrezique të tjera që çojnë në stres në punë (p.sh ndryshimet e shpejta në procedurat e punës, situatat konfliktuoze, përcjellja në vazhdimësi e inovacioneve dhe aplikimi i tyre në praktikë, puna me të holla, etj. |
| | Rreziqet ergonomike |
| 39 | Ngritja dhe mbajtja e ngarkesave |
| 40 | Puna që përfshin pozicion të dobët (pozicion të papërshtatshëm), lëvizje përsëritëse, shtrirje të zgjatur |
| 41 | Puna me ekrane |
| 42 | Mbingarkesa e zërit |
| **Rreziqet biologjike** | |
| 43 | Viruse, parazitë, myk, baktere |
| 44 | Kafshë, gjarpërinj etj. |

- Lista indikative e rreziqeve kyçe në vendin e punës
- Rregullore Nr. 02/ 2021 për vlerësimin e riskut në vendin e
- punës në shtojcë ka këtë listë – Shtojca 1

# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

**Puna me pajisje**, puna në lartësi, puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.



Rregullësia e pajisjeve duhet të verifikohet përmes:



# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, **puna në lartësi,** puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.

**Teknikat**

- **Kufizimi i qasjes**
- **Pozicioni punues (qasja me litar)**
- **Ndalja e rënies**



**Puna në lartësi**

# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, **puna në lartësi,** puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.

Punë në lartësi llogaritet puna në nivelin mbi **2m** nga dyshemeja, rrafshi me lëvizje të lirë e të sigurt.

Mbrojtja e punëtorëve nga puna në lartësi/ Përmbushja e kushteve për punë në lartësi:

- Aftësimi për punë në lartësi
- Kontrollimi i aftësive shëndetësore të punëtorëve për punë në lartësi
- Përdorimi i teknikave dhe masave të sigurisë
- Përdorim i drejtë i mjeteve dhe pajisjeve personale dhe atyre ekipore për punë në lartësi



# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, **puna në lartësi,** puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.

**Kufizimi i qasjes**

- Parmakët, janë barriera fizike ose struktura mbrojtëse të instaluara përgjatë skajeve, vendkalimeve, platformave ose zonave në lartësi të punës për të siguruar stabilitet dhe mbështetje për punëtorët

- **Rregullore (MPMS) Nr.06/2017** Për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vend ndërtimet e përkohshme apo mobile – Shtojca 4





## FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, **puna në lartësi,** puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.

**Siguria gjatë përdorimit të pajisjeve ngritëse**

Rreziqet, masat gjatë punëve në ndërtimtari – ashensorëve dhe vinçave.

- Vinçat kullë/ vinçat e lëvizshëm
- Shembja e vinçit – potencial i madh për lëndime kolektive
- Rënia e ngarkesës
- Lëndime me pasoja të mëdha edhe jashtë zonës së ndërtimit



# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, puna në lartësi, **puna në gërmime,** rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, siguria elektrike, etj.



- Puna e gërmimit në përgjithësi nënkupton punën që përfshin largimin e dheut ose shkëmbit nga një vend për të formuar një vrimë ose zgavër të hapur, duke përdorur mjete, makineri, etj.

- Dështimet e gërmimit janë veçanërisht të rrezikshme sepse ato mund të ndodhin shpejt, duke kufizuar aftësinë e punëtorëve (dhe në disa raste të tjerëve aty pranë) për të shpëtuar, veçanërisht nëse kolapsi është i gjerë.

## FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, puna në lartësi, puna në gërmime, **rrëshqitjet & pengimet**, siguria nga zjarri, siguria elektrike

### Rrëshqitjet dhe pengimet – masat parandaluese

- Pastërtia dhe mirëmbajtja
- Instalimi i sipërfaqeve rezistente ndaj rrëqshqitjes
- Sinjalizimi dhe komunikimi i duhur
- Ndriçimi adekuat
- Praktikat e mira shtëpiake
- Këpucët e duhura për ambientin përkatës
- Trajnimi dhe ndërgjegjësimi
- Inspektimi i rregullt dhe vlerësimi i riskut



# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, puna në lartësi, puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, **siguria nga zjarri**, siguria elektrike, etj.

**Lënda djegse**

**Trekëndëshi i djegies**



**Nxehtësia (temperatura e djegies)**

**Oksigjeni $O_2$**








# NË VAZHDIM DO TË SHIKOJMË NJË VIDEO PËR PËRDORIMIN E AKZ




ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## MËNYRAT E SHUARJES SË ZJARRIT

| Mënyra e gabuar | | Mënyra e duhur |
|---|---|---|
|  | Të sulmohet në drejtim të erës |  |
|  | Të fillohet me shuarjen e zjarrit nga poshtë – lart |  |
|  | Kur shkaktohet nga lëndët rrjedhëse të shuhet nga lart |  |
|  | Të gjitha aparatet të aktivizohen përnjëherë dhe jo një nga një |  |
|  | Kujdes nga ri-ndezja! Pas fikjes (shuarjes) së zjarrit e tërë sipërfaqja e vatrës së zjarrit të mbulohet me ujë |  |
|  | Aparatet e përdorura të mos vendosen në vendin e tyre, por të dërgohen për rimbushje |  |

# NË VAZHDIM DO TË SHIKOJMË NJË VIDEO “EVAKUIMI EMERGJENT”



# FAKTORËT E RISKUT TË LIDHUR ME LËNDIMET (TRAUMATIKE)

Puna me pajisje, puna në lartësi, puna në gërmime, rrëshqitjet & pengimet, siguria nga zjarri, **siguria elektrike**, etj.



- Siguria elektrike është e një rëndësie të madhe si në mjediset rezidenciale ashtu edhe në ato komerciale.
- I referohet masave preventive dhe praktikave të mira për të parandaluar rreziqet elektrike dhe për të siguruar mirëqenien e individëve dhe mbrojtjen e pronës.
- Kuptimi dhe zbatimi i masave të duhura të sigurisë elektrike është thelbësor për të parandaluar aksidentet, lëndimet dhe madje edhe vdekjet.
- Siguria elektrike përfshin disa aspekte kyçe, duke përfshirë instalimin e duhur të sistemeve elektrike, mirëmbajtjen dhe inspektimin e rregullt të pajisjeve elektrike dhe ndjekjen e praktikave të sigurta kur punoni me energji elektrike. Kjo përfshin përdorimin e mjeteve të duhura, pajisjeve të përshtatshme personale mbrojtëse dhe respektimin e udhëzimeve përkatëse.

- Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës
- Rregullore (MPMS) Nr.02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës

# SHENJAT E SIGURISË

## DALLIMI I SHENJAVE TË SIGURISË

| | |
|---|---|
| Obligative | |
| Ndaluese | |
| Paralajmërim i rrezikut | |
| Pajisjet kundër zjarrit | |
| Emergjente | |

## RREGULLAT E SIGURISË NË PUNË DHE MJEDISIT NË HAPËSIRAT E PUNËS

- TË GJITHË PERSONAT QË HYJNË NË HAPËSIRAT E PUNËS DUHET TË JU PËRMBAHEN RREGULLAVE DHE UDHËZIMEVE.
- TË GJITHË VIZITORËT DUHET TË LAJMËROHEN TE PERSONI PËRGJEGJËS DHE KALOJNË NË PROCEDURAT E SIGURISË
- GJITHMONË NJOFTONI PERSONAT PËRGJEGJËS PËR SITUATAT E PASIGURTA, INCIDENTET DHE AKSIDENTET NË VENDIN E PUNËS.

**KUJDES! Duhet të respektohen shenjat e sigurisë, rrugët e përcaktuara për lëvizje**

- Kujdes i përgjithshëm! Në zonën e punës varësisht nga procesi i punës dhe pajisjet/ makinat që përdoren
- Kujdes në zonën e punës të pirunierit, paletarit, pajisjeve tjera bartëse dhe automjeteve tjera
- Ngarkesa mbi kokë - nuk duhet të qëndrohet nën ngarkesë
- Qëndo në rrugët e përcaktuara të sigurisë/ lëvizjes
- Rënie nga lartësia
- Pengesat në hapësirat e punës
- Sipërfaqet e rrëshqitshme
- Kujdes nga kontakti me tension

**NDALOHET improvizimi/ modifikimi i pajisjeve, veglave, mjeteve dhe materialeve**

- Ndalohet qasja për persona të paautorizuar
- Ndalohet hudhja e mbeturinave në vende të pacaktuara
- Ndalohet lënia e pajisjeve, veglave, mjeteve dhe materialeve në vende të pacaktuara
- Ndalohet pirja e duhanit
- Ndalohet ushqimi në hapësirat e punës

**OBLIGOHET kontrollimi i pajisjeve, veglave dhe mjeteve para dhe pas çdo pune**
**OBLIGOHET përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse**

- Rrobat e punës *(varësisht nga procesi i punës)* Jeleku vezullues
- Këpucët e punës
- Helmeta
- Dorëzat e punës
- Rripi i sigurisë për ngritje në lartësi
- Mbrojtja e syve (syzet)
- Mbrojtja e veshëve (kufjet)
- Maska mbrojtëse
- Pajisja mbrojtëse e fytyrës *(varësisht nga procesi i punës)*
- Leximi i udhëzimeve të sigurisë

**Duhet të respektohen rrugët EMERGJENTE, si dhe plani për evakuim & shpëtim**

- Pika e vendgrumbullimit
- Dalja emergjente
- Ndihma e parë
- Aparati për fikjen e zjarrit
- Hidranti për fikjen e zjarrit
- Qendra e thirrjeve në kuadër të Policisë 112
- Policia 192
- Ndihma e Shpejtë 194
- Zjarrfikësit 193
- Sinjalizuesi manual për dhënien e alarmit

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Baza ligjore - RREGULLORE (MPMS) Nr. 04/2016 PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN E SHENJAVE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË





# PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE

Në përputhje me trajnimin, udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, doracakët, procedurave dhe rregulloret teknike, i punësuari është i detyruar t’i përdorë me korrektësi:

- Mjetet e punës
- Makinat
- PPM (pajisjet personale mbrojtëse)
- Mos improvizimi/ përpunimi i asnjë pajisje apo materiali
- Të njoftoj menjëherë përgjegjësin e tij apo personin për siguri në punë për çdo situatë të rrezikshme








ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

# KONTROLLET SISTEMATIKE MJEKËSORE

- Baza ligjore – UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 04/2013 PËR CERTIFIKATAT SHËNDETËSORE
- LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI
- LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË



Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-161 punëdhënësi është i detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës, këto kontrolle duhet të bëhen së paku një herë në tre (3) vite.



# NDIHMA E PARË



ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## VEPRIMET NË RAST TË INCIDENTEVE, AKSIDENTEVE DHE ZJARRIT

### Në rast të ndonjë Emergjence

- Qëndro i qetë!
- Largo rrezikun dhe shpëto njerëz, nëse është e mundur!
- Njofto Policinë!

### Numrat me rëndësi në raste Emergjente

- Qendra e thirrjeve në kuadër të Policisë .................... 112
- Policia .................... 192
- Zjarrfikësit .................... 193
- Ndihma e Shpejtë .................... 194
- Ndihma e Shpejtë .................... 038 500 094
- Qendra Klinike Universitare .................... 038 500 600
- **Njofto personat përgjegjës në kompani/ hapësirat e punës**

### Njofto Ndihmën e Shpejtë

- Kush po telefonon?
- Çfarë ka ndodhur?
- Ku ndodhesh?
- Personat e lënduar?
- Çfarë lëndimesh kanë pësuar?
- Prisni për përgjigje!

### Njofto Zjarrfikësit

- Ku ndodhet zjarri?
- Çfarë po digjet?
- A janë njerëzit në rrezik?
- Kush po telefonon?
- Prisni për përgjigje!

### Veprimet që duhet të ndërmerren

- Largohu nga zona e rrezikut
- Shkyçni furnizimin me energji elektrike
- Ndihmoni të lënduarit dhe personat me aftësi të kufizuar
- Jep ndihmën e parë personave të lënduar, duke kontrolluar vetëdijen dhe frymëmarrjen
- Fikni zjarrin dhe përdorni aparatin për fikje të zjarrit, varësisht nga lloji i zjarrit
- Përdorni rrugët e daljeve emergjente dhe zhvendosu në një vend të sigurt
- Largohuni nga dhoma me tym duke u përkulur apo zvarritur
- Shkoni te pika e vendgrumbullimit
- Mos përdorni ashensorët
- Mbyllni dyert dhe dritaret por jo me çelës
- Ndiqni udhëzimet e Zjarrfikësve dhe personave të tjerë përgjegjës

## DHËNIA E NDIHMËS SË PARË

**Kontrollimi i vetëdijes**



Ka vetëdije → **I kontaktushëm** — Trajtimi i shokut



Pa vetëdije

**Kontrollimi i frymëmarrjes**



Ka frymëmarrje → **Pa vetëdije, por me frymëmarrje** — Pozita stabile anësore (rehabilituese)



Nuk ka frymëmarrje

**Kontrollimi i pulsit**



Ka puls → **Nuk ka frymëmarrje, por ka puls të pranishëm** — Dhënia e frymëmarrjes artificiale



Nuk ka puls

**Nuk ka frymëmarrje**
**Nuk ka puls**

*2x Dhënia e frymëmarrjes artificiale 30x Masazhi i zemrës*

Kur personit të lënduar i ndalet zemra: Riaktivizimi i zemrës dhe mushkërive

Fillohet me dy (2) dhënie të frymëmarrjes artificiale, të tentohet me riaktivizimin e zemrës dhe mushkërive, deri sa të aksiden-tuarit/ lënduarit t'i kthehet frymëmarrja dhe rrahjet e zemrës apo deri sa ta marrë në mbikëqyrje ndihma e shpejtë ose mjeku



Dhënia e frymëmarrjes artificiale



Masazhi i zemrës

# ANALIZA E VENDEVE INDIVIDUALE TË PUNËS – EKRANET SHFAQËSE

- Mjedisi i punës
- Rregullimi i vendit të punës
- Software-i
- Pajisjet e hardware-it
- Organizimi i punës





# TRAJTIMI MANUAL I NGARKESAVE




- Lëvizja apo mbështetja e çdo ngarkese me përpjekje fizike duke përfshirë:
  - Ngritjen
  - Vendosjen poshtë
  - Shtyrjen
  - Tërheqjen
  - Mbajtjen
  - Lëvizjen



- Përdorimi i pajisjeve ndihmëse mekanike si karrocat, pirunarët, platformat ngritëse & bartëse përfshihet poashtu në trajtimin manual të ngarkesave.



# ÇKA ËSHTË VLERËSIMI I RISKUT?



- “Vlerësimi i riskut në vendin e punës” nënkupton një procedurë që përcakton nivelin e riskut që është kombinimi i gjasave që i punësuari mund të lëndohet ose mund të ketë efekte shëndetësore që vijnë nga rreziqet që ekzistojnë në mjedisin e tij/saj të punës, si dhe nivelin e pasojave/ashpërsisë të mundshme të lidhura me lëndimet në punë, sëmundjet profesionale, sëmundjet që lidhen me punën dhe efekte të tjera shëndetësore.

- “Rreziku në vendin e punës” nënkupton çdo burim të dëmtimit të mundshëm ndaj të cilit mund të ekspozohet një i punësuar në punë dhe që mund të shkaktojë dëm ose efekte të dëmshme në shëndetin e të punësuarve. Në Shtojcën 1 të rregullores nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës, jepet një lista indikativë e rreziqeve kryesore në vendin e punës.

# KËRKESAT LIGJORE PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr. 04/L-161, dhe rregulloreve të dalur po nga ky Ligj.

Rregullore (MPMS) Nr. 02/2021 per vleresimin e riskut ne vendin e punes

Legjislacioni dhe rekomandimet evropiane

Praktik e mirë: ISO 45001

# KËRKESAT LIGJORE PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS




ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## HAPAT E VLERËSIMIT TË RISKUT NË VENDIN E PUNËS

- Baza ligjore – RREGULLORE (MPMS) Nr. 02/2021 PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS



Risku (R)
Vlerësimi i gjasave/probabilitetit (L – Likelihood/ P – Probability)
Vlerësimi i ashpërsisë/pasojës (S – Severity/ C – Consequence)

**R = L x S**

** Shumëzimi i nivelit të gjasës/probabilitetit (L – nga 1 deri 5) me nivelin e ashpërsisë/pasojës (S – nga 1 deri 5) e përcakton nivelin e riskut. Niveli i riskut klasifikohet në një shkallë nga 1 deri 25.

| | | **ASHPËRSIA / PASOJA** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1 Minimale** | **2 Minore** | **3 Mesatare** | **4 Madhore** | **5 Katastrofike** |
| **GJASA / PROBABILITETI** | **1 Rrallë (Shumë pak e mundur)** | 1 I pranueshëm | 2 I tolerueshëm | 3 I tolerueshëm | 4 I tolerueshëm | 5 I tolerueshëm |
| | **2 Nuk ka gjasa (pak e mundur)** | 2 I tolerueshëm | 4 I tolerueshëm | 6 Mesatar | 8 Mesatar | 10 Mesatar |
| | **3 E mundshme** | 3 I tolerueshëm | 6 Mesatar | 9 Mesatar | 12 Mesatar | 15 Madhor |
| | **4 Ka gjasa (shumë e mundur)** | 4 I tolerueshëm | 8 Mesatar | 12 Mesatar | 16 Madhor | 20 Madhor |
| | **5 Pothuajse e sigurt** | 5 I tolerueshëm | 10 Mesatar | 15 Madhor | 20 Madhor | 25 I pa tolerueshëm |

# METEDOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS

| **Kategoria e gjasave** | **Përkufizimi** |
|---|---|
| **5 Pothuajse e sigurt** | Pothuajse e sigurt që ngjarja do të ndodhë gjatë procesit të punës (çdo ditë). |
| **4 Ka gjasa (shumë e mundur)** | Ngjarja mund të ndodhë disa herë gjatë procesit të punës (një herë në javë). |
| **3 E mundshme** | Ngjarja mund të ndodhë në një të ardhme të afërt (brenda muajit). |
| **2 Nuk ka gjasa (pak e mundur)** | Ngjarja ka pak mundësi të ndodhë (mund të ndodhë të paktën një herë në vit). |
| **1 Rrallë (Shumë pak e mundur)** | Ngjarja nuk ka gjasa të përsëritet - mund të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme në > pesë vjet. |

| **Ashpërsia e ndodhjes** | **Përkufizimi** |
|---|---|
| **5 Katastrofike** | Vdekje ose humbje e rëndë e përhershme e aftësisë. |
| **4 Madhore** | Humbje madhore e rëndë e përhershme ose e përkohshme e aftësisë. Dëmtime madhore që kanë nevojë për trajtim dhe shtrim spitalor që shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për kohë më të gjatë). |
| **3 Mesatare** | Humbje e moderuar e përhershme ose e përkohshme e aftësisë. Dëmtime mesatare që kanë nevojë për trajtim spitalor që shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për disa ditë). |
| **2 Minore** | Dëmtime të vogla/lehta që kanë nevojë për ndihmën e parë dhe trajtim mjekësor, që mund të shkaktojnë orë të humbura në procesin e punës (për pak ditë). |
| **1 Minimale** | Pasojë minimale, pa lëndime por mund të ketë nevojë për ndihmën e parë. Personi mund të vazhdojë procesin e punës. |

| REZULTATET | VEPRIMET E KËRKUARA |
| --- | --- |
| **(25)** **Risqet e pa tolerueshme** | Këto risqe janë të papranueshme. Janë të nevojshme përmirësime thelbësore në masat e kontrollit të riskut në mënyrë që risku të reduktohet në një nivel të tolerueshëm ose të pranueshëm. Aktiviteti i punës duhet të ndalet derisa të zbatohen kontrollet e riskut që të reduktohet risku në mënyrë që të mos jetë më shumë i lartë. Nëse nuk është e mundur të zvogëlohet risku, puna duhet të mbetet e ndaluar. |
| **(15, 16, 20)** **Risqet madhore** | Duhet të bëhen përpjekje thelbësore për të zvogëluar riskun. Masat e zvogëlimit të riskut duhet të zbatohen brenda një periudhe kohore të përcaktuar dhe mund të jetë e nevojshme të merret në konsideratë kufizimi i aktivitetit, ose të zbatohen masa të përkohshme të kontrollit të riskut, derisa kjo të përfundojë. Burime të konsiderueshme duhet të alokohen për masa shtesë të kontrollit. Duhet të bëhen aranzhime për të siguruar mbajtjen e kontrolleve, veçanërisht nëse nivelet e riskut shoqërohen me pasoja jashtëzakonisht të dëmshme dhe pasoja shumë të dëmshme. |
| **(6, 7, 8, 9, 10, 12)** **Risqet mesatare** | Duhet të merren masa dhe bëhen planifikime nëse risqet mund të ulen, kur është e zbatueshme, në një nivel të tolerueshëm dhe mundësisht në një nivel të pranueshëm, por kostot e masave shtesë të zvogëlimit/reduktimit të riskut duhet të merren parasysh. Masat e zvogëlimit të riskut duhet të zbatohen brenda një periudhe kohore të përcaktuar. Duhet të bëhet planifikim për të siguruar mbajtjen e kontrolleve, veçanërisht nëse zona e niveleve të riskut shoqërohet me pasoja të dëmshme. |
| **(2, 3, 4, 5)** **Risqet e tolerueshme** | Nuk kërkohen kontrolle shtesë nëse ato nuk mund të zbatohen me kosto shumë të ulët (për sa i përket kohës, buxhetit dhe përpjekjeve). Veprimeve për të zvogëluar më tej këto risqe u jepet përparësi e ulët. Duhet të bëhet planifikim për të siguruar mbajtjen e kontrolleve. |
| **(1)** **Risqet e pranueshme** | Këto risqe konsiderohen të pranueshme. Asnjë veprim i mëtejshëm nuk është i nevojshëm përveç sigurimit të mbajtjes së kontrolleve. |

## FORMA E VLERËSIMIT TË RISKUT

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kompania:** | | **Vendi i punës:** | |
| **Departamenti/Njësia:** | | **Numri i punëtorëve:** | |
| **Lokacioni:** | | **Nr. i formës së VR:** | |

| Nr. | Burimi i rrezikut | Përshkrimi i rrezikut | Ndikimi | Personi/ Grupet e ndikuara | Masat ekzistuese | VLERËSIMI | | | Masat korrigjuese dhe parandaluese | Referenca në legjislacionin vendor ose ndërkombëtar | Matjet | Personat përgjegjës/ Data e rishikimit | Risku i mbetur |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vlerësimi i gjasave (L) | Vlerësimi i ashpërsisë (S) | Niveli i riskut (R) | | | | | |
| 1 | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | | | | |

